



# KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE

Tel/Fax: +381 38 22 77 82; Mob: +377 44 622 000 E-mail: kosovaolimpic@yahoo.com  
Adresa: Rr. Agim Ramadani nr.43, Shtëpia e Sporteve, kati I, nr 10, 10000 Prishtinë, Kosovë

## EKSTRAKT

### Nga Mbledhja e 21 e BE te KOK, e mbajtur me 30 Gusht 2014

Prezent: Besim Hasani, Shasivar Haxhijaj, Fatmir Makolli, Artan Rugova, Ramadan Selimi, Shqipe Zogiani, dhe Arben Lila. **Munguan:** Fadil Vokri, Nezir Rama, Vjollca Krasniqi (me arsye) dhe Ismail Kosumi e B. Gerbic (pa arsye)

Te pranishmit unanimisht miratuan Rendin e Ditës ne vijim me nje plotesim nen piken 4 (Kerkesa e Federates se Mundjes per shperblim te perhereshem per Mustafe Sylen, dhe Rendi i Dites ishte:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit nga Mbl e 20 e BE te KOK, e mbajtur me 29.04. 2014**
2. **Aktivitetet midis dy mbledhjeve te BE te KOK dhe detyrat e kryera**
  - a) 5 Qershori-Dita e Ambientit (Raportojne:Shqipja, Besimi, Fatmiri, Neziri)
  - b) 23 Qershori-Dita Olimpik (Raportojne: Besimi, Fatmiri, Neziri, Jetoni)
  - c) Forumi Boteror i gruas, i mbajtur ne Helsinki (11-16.06.2014) (Raporton: Shqipja)
  - d) Vizita e Presidentit Hasani ne KON, 10 Korrik 2014 (Raporton: Besimi)
  - e) Vizita e Presidentit Hasani ne KOKSH, e realizuar me me 4 Gusht 2014 (Raporton:Besimi)
3. **Verifikimi dhe propozimi per shperblim per Majlinda Kelmendin (Garuese) dhe Driton Kuken (trajner) per medalejn e Arte ne Kampionatin Boteror te Xhudos "Chelyabinsk 2014"**
4. **Shqyrtimi dhe marrja e vendimit lidhur me kerkesat per shperblime te perhershme nga Federata e Boksit dhe Federata e Mundjes per:**
  - a) Bajram Hashanin, fitues i medaljes se BRONZTE ne Kampionatin Evropian te Boksit, te mbajtur ne Katovice te Polonise, me 1-8 Qershor 1975
  - b) Sami Buzollin, fitues i medaljes se BRONZTE ne Kampionatin Boteror te Boksit, te mbajtur ne Minhen te Gjermanise, me 4-15 Maj 1982. Sami Buzolli ka fituar edhe dy medalje te ARGJENTA ne dy Kampionate Evropiane, ne Tampere te Finlandes ne vitin 1981 dhe ne Varne te Bullgarise ne vitin 1983
  - c) Mustafe Syla, fitues i medaljes se argjente, 57 kg ne Kampionatin Evropian te mbajtur ne Lapua te Finlandes ne vitin 1990
5. **Aktivitetet e BE te KOK gjate Gushtit dhe Shtatorit:**
  - a) Vizite pune ne Komitetin Olimpik e Sportiv te Gjermanise, e planifikuar per 12 Shtator 2014 (pritet konfirmimi definitiv nga pala gjermane). Pervec Besimit udheton edhe nje anetar i BE
  - b) Informate rreth pergatitjeve per Diten e Sportit
6. **Te ndryshme**

## **PIKA 1**

Ekstrakti nga Mbledhja e 20 e BE te KOK e mbajtur me 29.04.2014 u miratua pa verejtje.

### **Pika 2.**

- a) Shqipe Zogiani, Besim Hasani dhe Fatmir Makolli informuan per organizimin me sukses te Dites se Mjedisit te mbajtur me 5 Qershor 2014 ne bashkepunim me KK te Prishtines dhe OJQ "REK"
- b) Besim Hasani, Shqipe Zogiani dhe Fatmir Makolli informuan lidhur me aktivitetin e suksesshem per nder te Dites Olimpikje Nderkombetare e mbajtur ne Prishtine me 23 Qershor 2014. Musafir nderi ishte Presidenti i KOKSH z.Viron Bezhani.  
Rreth kesaj pike diskutuan edhe Shasivar Haxhijaj, Ramadan Selimi, Arben Lila dhe Artan Rugova te cilet nenvizuan nevojën e angazhimit me te madh te anetareve te BE dhe te vullnetreve por edhe te stffit me pagese ne menyre qe Presidenti te lirohet nga angazhimi i drejteperdrejte dhe te luaj rolin e liderit e jo te menagjerit. Ne kete menyre, u tha, do te ruhet imazhi i Presidentit por edhe i BE te KOK
- c) Shqipe Zogiani informoj per pjesemarrjen e saj si anetare e Komisionit Sporti dhe Femra, ku ishin prezente edhe Aferdita Fazlija kryetrare dhe Sanije Krasniqi anetare, ne Forumin nderkomebetar te Gruas te mbajtur ne Helsiniki nga 12-16 Qershor 2014 dhe pershtypjet e perfitimet e larta nga kjo pjesemarrje, per pervojat e fituar edhe gatishmerine e ketij Komisioni te organizojne nje konference Sporti dhe femra ne Kosove. Ideja per nje organizim te tille u mbeshete nga te gjitha anetaret e BE te KOK. Shpenzimet kishin kaluar vleren e projektit per 437 euro dhe BE miratoj tejkalimin dhe vendosi qe keto mjete te meren nga ndonje projekt tjeter me vendimin me shkrim nga Sekretari i MKRS
- d) Besim Hasani informoj BE te KOK per viziten zyrtare te tij ne KON, me 10 e 11 Korrik 2014, per takimin me Presidentin e KON z. Thomas Bach dhe me drejtorin e KON, z Pere Miro dhe bashkepunetoret e tij. Vizita u cilesua shume premtuese pasi qe KON kishte shprehur gatishmerine te ndaj Bursa Olimpikje per Shpresat Olimpikje te Kosoves nepermjet Federatave Nderkombetare. Inkuarajuese ishte edhe qendrimi i KON rreth mundesise se dhenies se shpejte te sinjalit per aplikim per njohje te KOK nga KON. Keto biseda dhe kontakte do te jene te shpeshta dhe te drejteperdrejte ne muajt ne vijim midis KOK dhe KON dhe se KON duhet te furnizohet me informata te perditesuara nga KOK sa i perkete progresit politik dhe sportiv ne Kosove.
- e) Besim Hasani informoj BE te KOK per viziten e tij njeditore ne KOKSH dhe vazhdimin e bisedimeve per organizimin e nje aktiviteti te perbashket me gara sportive midis Kosoves e Shqiperise ne disa sporte qofte me seniore apo juniore por u la mundesia edhe me veterane. Nje garë e tille do te mbahej psh ne Durres, ne fillim te Tetorit te ketij viti dhe do te shkohej me nje autobus.

### **PIKA 3.**

Besim Hasani informoj se nje dite me pare ishte shqyrtuar kerkesa e Federates se Xhudos se Kosoves per ndarje te Shperblimit per medaljene arte nga Kampionati Boteror i Xhudos "Chelyabinsk 2014" ku u fitua medalja earte nga Majlinda Kelmendi (52 kg) dhe trajneri i saj Driton Kuka, andaj BE i KOK miratoj vendimin per rekomandim qe MKRS te ndaj per Majlinda Kelmendin 40.000 euro dhe per Driton Kuken 20.000 euro bazuar ne Rregulloren perkatese te MKRS te miratuar nga Qeveria e Kosoves

### **PIKA 4.**

Kerkesa e Federates se Boksit per ndarjen e shperblimeve te perhereshme per Bajram Hashanin dhe Sami Buzollin u vendos te shtyhet per mbledhjen e radhes te BE te KOK dhe ne nderkohe te kerkohet nga Federata e Boksit e Kosoves qe te kerkoj nga Bajram Hashani dhe Sami Buzolli deklarimin me shkrim se "te arriturat e tyre sportive ia atribuojne shtetit te Republikes se Kosoves dhe secili prej tyre duhet te beje kerkesa individuale qe rezultatet e tyre te jene te regjistruara ose te barten ne Republikën e Kosoves, nese

te njejtat rezultate jane te regjistruara ne ndonje shtet tjetër” (Neni 9 i Rregullores nr 14/2013 vper mbeshtetje te perhershme finciare te sportisteve te cilet kane fituar medalje ne Lojerat Olimpike, ne Kampionatet Boterore dhe Kampionatet Evropiane e miratuar ne Mbledhjen e128 te qeverise se Kosoves me vendimin nr.03/128 mr date 02.05.2013

Ndersa lidhur me kerkesen e Federates se Mundjes per ndarjen e shperblimit te perhershem per Mustafe Sylen u vendos te kerkohet sqarim plotesues nga Zyrja Ligjore e MKRS se a perfshihen ne shperblime te perhershme edhe Kampionatet per Kadete e Juniore ne Rregulloren nr. 14/2013 per mbeshtetje te perhershme finciare te sportisteve te cilet kane fituar medalje ne Lojerat Olimpike, ne Kampionatet Boterore dhe Kampionatet Evropiane e miratuar ne Mbledhjen e128 te qeverise s e Kosoves me vendimin nr.03/128 mr date 02.05.2013. Kerkesa me shkrim i dergohet Zyres Ligjore me daten 1 Shtator 2014 dhe kerkojme qe ne afatin sa me te shpejte te marrim pergjegje zyrtare.

#### PIKA 5.

- a) Besim Hasani informoj BE te KOK se nga 1 shtatori 2014 do te udhetoj ne Lozane ne vazhdimi te marrevshjes se arritur nga vizita e 10 e 11 Korrikut te vitit 2014.
- b) Nga bashkepunetoria e KOK ne Gjermani zonja Megi Mass eshte aranzhuar takimi i perfaqesuesve te KOK me KO te Gjermanise. BE i KOK vendosi qe Presidenti dhe nenpresidenti, Besim Hasani e Fatmir Makolli te udhetojne se bashku. Data orientuese e takimit eshte caktuar me 12 Shtator por ne nderkohe presim konfirmimin definitiv nga pala gjermane!
- c) Ne javen e fundit te Shtatorit, mbase me 25 apo 26 Shtator ne Sheshin Nena Tereze do te organizohet Dita/panairi i Sportit. Ideja eshte marruar nga Dita e sportit ne Vjene qe tradicionalisht organizohet per cdo vit ne javen e trete te shtatorit! Cdo Federate para femijeve te Cerdheve dhe nxenesve te Shkollave fillore te Komunes se Prishtines demonstrojne oferten e tyre sportive per te nxitur kureshtjen dhe deshiren e vizitoreve per te praktikuar sportin e tyre!

#### PIKA 6.

BE i KOK vendosi:

- a) Nga Fondi i KOK te mbulohen shpenzimet telefonike per Besim Hasanin, President i KOK dhe Jeton Rudarin, sekretar teknik ne KOK ne vlere 50 euro ne muaj, respektivisht 25 euro ne muaj. Ne vitin e ardhshem kjo shume mund te rritet!
- b) Cdo antere i BE te KOK te mendoj per aktivitetet qe do te organizohen ne vitin 2015, ne harmoni me Planin startegjik per Ciklin Olimpik deri ne vitin 2016 ku perfshihet edhe buxheti financiar i cili duhet te jete deri ne 5 here me i larte se buxheti 9 mujorit te vitit 2014. Normalisht nuk duhet te presim se sponsor i vetem te jete MKRS por duhet gjetur edhe burime tjera financiare andaj u vendos te gjenedet nje agjenci e specilaizuar per marketing e cila do te paguhej ne vlere deri ne 20% nga shuma qe derdhet ne xh.ll e KOK. Poashtu u vendos qe cdo anetar i BE te KOK te shperblehet me 10% nga shuma qe derdhet ne xh.ll e KOK ne mer te ndermjetesimit midis KOK dh esponsorit apo donatorit potencial. Kjo e dyta hyne ne fuci vetem nese nuk ka pengesa ligjore per nje marrevshje te tille!
- c) Asambleja e rregullt e KOK te mbahet nga fundi i Tetorit 2014, e para saj mund te mbahet nje mbedhje tjeter statutare, nse nje gje etille kerkohet nga KON

Mbledhja perfundoj ne ora 12,00

Ekstrakti u perpilua nga Besim Hasani, bazuar ne Procesverblin e udhehequr nga Jeton Rudari

Obligimet qe dalin nga vendimet e BE te KOK nga Mbledhja e 21 e dt 30 Gusht 2014

1. Ekstarkti i dergohet menjehere te gjithë anetraeve te BE te KOK (Jetoni)
2. Leter Zyres ligjore te MKRS (Jetoni ne baze te ekstarktit)
3. Leter Federates se Boksit te Kosoves (Jetoni ne baze te ekstarktit)
4. Meditjet per Mbledhje te BE te KOK te paguhen menjeher per te gjithë anetaret e BE qe kane qene prezent ne 5 mbledhjet e mbajtura ne vitin 2014 dhe meditjet per Komisione (Jetoni ne baze te ekstarkteve te mbledhjeve 17, 18, 19, 20 dhe 21)
5. Te hulumtohet cfare dokumentacioni nevojitet per vize finlandeze ne Ambasaden perkatese ne Prishtine dhe ju dergohet anetareve te BE te KOK me vlefshmeri per ata qe nuk posedojne viza Shengen. (Jetoni i merre informatat nga interneti ose shkon te henen me 1 shtator ne ambasaden e Finlandes dhe ne baze te formularit per aplikim i ka informatat)
6. Kur te grumbullohen dikumentet, Besim hasani kerkon takim me ambasadoren e Finlandes dhe kerkon viza se paku njevejecare per anetret e BE te KOK
7. Te deshmohet nga ndonje auditor ligjshmeria se a kane te drejte anetaret e BE te KOK ne 10% per gjetjen e sponsorit (Jetoni)
8. Te hulumtohet ndonje agjenci marketingu dhe te ftohet ne KOK per bisreda (te gjithë anetaret e BE te KOK dhe Jetoni)
9. Te kontaktohet kryesoret e OJQ Albania per gjetje te mundesise se bshkepunimit KOK Albania
10. Jetoni te kerkoj nga MSHP se cka nevojitet per ndrrimin e emrit nga Asociacioni i Komitetit Olimpik te Kosoves ne KOK
11. Themeluesit (Besimi, Mehmeti, Beluli e nenshkruajne dokumentacionin e nevojshem per ndrrim te emrit nga AOK ne KOK ne baze te vendimit te Asamblese se IV apo te V te KOK
12. Vazhdimi i pergatitjeve per Diten e Sportit (Komisioni dhe BE & Jetoni)
  - a) Jetoni te henen shkon te Arberia dhe insiston qe se bashku te shkojne ne drejtoreite perkates edhe te caktojne Diten kur Sheshi eshet ne disponim te KOK tere ditën
  - b) Pas et caktohet dita, Jetoni ne baze te instruksioneve me shkrim, bisedon me te gjitha federatat qe jane ne Shtepin e sporteve qete fillojne te pergatiten (duke perdorur imagjinate se si do et prezentohen pra mijera femijeve per te qene sa me atraktiv
  - c) Jetoni merre informata nga dhenesit me qira te tendave lidhur me cmimet e huazimit njeditor te tendave te dimensioneve te ndryshme, sa per ti informuar federatat